



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosova
Qeveria/Vlada/Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/agjencia za Razvoj Poljoprivrede/Agency for Development of Agriculture

UDHËZUES PËR PËRFITUES PËR PËRGATITJEN E PAKOS PËR PAGESË

Kur parashtrohët Kërkesa për Pagesë

- Pasi të finalizohet investimi i paraparë në plan biznes, Letrën Informuese dhe kontratë me AZHB,
- Kërkesa për Pagesë mund të parashtrohet edhe para përfundimit të afatit të Kontratës me kusht që investimi të jetë finalizuar dhe projekti të jetë funksional,
- Kërkesa për Pagesë do të refuzohet nëse tejkalohe afatet ligjore të përcaktuara me U/A 02/2017 dhe kontratën e nënshkruar ne mes të përfituesit dhe AZHB-së edhe përkundër investimeve të realizuara.

Afati i parashtrimit të Kërkesës për Pagesë

1. **MASA 101 dhe 302:** 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në përveç nënmasës së vreshtave që është 300 dhe nën masës së pemëve 150 ditë pas nënshkrimit të kontratës (kushtet optimale të mbjelljes),
 - 1.1 Pas skadimit te kontratës (120 -300 ditë) varësisht nga nënmasa përfituesi ka në dispozicion 15 ditë për përgatitjen dokumentacionit për kompletimin e Kërkesës për Pagesë,
 - 1.2 AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit por më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të forta për këtë, siç është respektimi i periudhave vegetative të bimët (p.sh periudha e mbjelljes së pemëve drufutore), sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi të huaj etj.
2. **MASA 103:** 10 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në,
 - 2.1 Pas skadimit te kontratës (10 muaj) përfituesi ka në dispozicion 15 ditë për përgatitjen dokumentacionit për kompletimin e Kërkesës për Pagesë,
 - 2.2 AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 2 muaj, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër etj.

Kujdes: Kërkesa për shtyrje të afatit duhet të behet para skadimit të afatit te rregullt të kontratës.

Procedurat e parashtrimit të Kërkesës për Pagesë

Bazuar në U/A 02/2017

1. Parashtrimi i kërkesës në ZR të AZHB-së (plotësohet formulari i kërkesës për pagesë duke ja bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar për secilen masë- nën masë),
2. Kërkesa dorëzohet nga përfituesi ose i autorizuari i përfituesit,
3. ZR regjistron kërkesën për pagesë në librin intern dhe kontrollon kompletshmërin e dokumentacionit në prani të përfituesit ose personit të Autorizuar,
 - Nese dokumentacioni është i kompletuar regjistrohet dhe fillon futja e të dhënave në system,
 - Nese dokumentacioni nuk është i kompletuar, ZR i AZHB-së regjistron kërkesën për pagesë por nuk e pranon kërkesën duke i dhanë një kopje dhe i kërkon plotësimin e dokumentacionit brenda afatit prej 5 ditë,
 - Nese dokumentacioni i kërkesës për pagesë nuk kompletohet brenda afatit prej 5 ditë kërkesa për pagesë refuzohet dhe merret vendim për shkëputje të kontratës.

Çka duhet patur kujdes te përgatitja e Pakos për Pagesë

1. Dokumentet të jenë të Kompletuara:

- Kopja e letërnjoftimit valid të Republikës së Kosovës (për personat fizikë) ose kopja e regjistrimit të biznesit (për personat juridikë), dokumenti që provon se kush e ka të drejtën e nënshkrimit në emër të kompanisë,
- Autorizimi i vërtetuar nga noteri (në rastin kur kërkesa dorëzohet nga i Autorizuari) dhe kopja e letërnjoftimit,
- **Faturat origjinale** që vërtetojnë shpenzimet për implementimin e projektit sipas **letres Informuese dhe planit të biznesit**,
- Urdhër pagesa/ transferi bankar (në rastet kur pagesa është kryer në bankë në vlerë mbi 500€) / kuponi fiskal (në rastet kur pagesa është kryer me para të gatshme nën 500 €) e cila i bashkëngjitet faturës dhe tregon se përfituesi e ka kryer pagesën,
- Pasqyra e llogarisë bankare që përfshin periudhën e pagesave që tregon se përfituesi e ka kryer pagesat (në rastet kur pagesat janë bërë me transfer në bankë) –vetëm për periudhën kur janë bërë pagesat për grantin investiv,

2. Vetëm në rast të projekteve të ndërtimit

- Lejen e ndërtimit lëshuar nga organi kompetent i Komunës,
- Pëlqimin e komunitetit në mjedisin ku planifikohet ndërtimi i stallës,
- Dëshminë e vlerësimit të ndikimit mjedisor, vetëm nëse parashihet me ligj,
- Lista kontrolluese për përzgjedhjen mjedisore.

Verejtje: Kompletu dokumentacionin sipas kërkesës shmang zvoglimin e vlerave të mbështetjes ose refuzimin e Kërkesës për Pagesë

3. Tek pemet duhet te jeni edhe keto dokumenta shtese NËNMASA: 101.1 Pemët
 - Dëshminë se fermeri është furnizuar me material fidanor nga kompania (subjekti), që është i licencuar si prodhues ose importues i materialit fidanor të pemëve nga MBPZHR,
 - Dëshminë mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor (certifikatën fitosanitare);
4. NËNMASA: 101,6 Rrushi
 - Dëshminë se fermeri është furnizuar me material fidanor nga kompania (subjekti), që është i licencuar nga MBPZHR si prodhues ose importues i materialit fidanor të te rrushit.
 - Dëshminë mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor (certifikatën fitosanitare) te prodhuar dhe të certifikuar në shtetet e Bashkimit Evropian.
4. Zbatimi strikt I Procedurave të Prokurimit a ty ku kërkohën

Procedurat e Prokurimit

1. Dispozitat e përgjithshme te zbatueshme per te gjitha llojet e blerjeve

- Asnjë nënkontraktues i kontraktuar nga perfituesi nuk mund të kontrakttojë ndonjë nënkontraktues tjetër për realizimin e kontrates;
- Blerjet duhet t'i respektojnë investimet që përmbushin kriteret e përshtatshmerisë të përcaktuara në kuader të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përket kthimit të investimeve, rrjedhes se parase, etj.
- Procedurat e prokurimit vlejnë vetëm për investimet e pranueshme. Për investimet papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtperdrejta, blerjet me se paku 3 oferta dhe përzgjedhje e bazuar në prokurim me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varesi të vlerës së blerjeve; Është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njejtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag me të lartë;
- Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt të interesit;
- Ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave; në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose nëse deshtojnë për të dhënë këtë informacion.
- Respektimi i rregullave të prokurimit është kusht i detyrueshem për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkeses duhet të përmbajë dokumentet e pagesave për të dëshmuar plotësimin e procedurave të prokurimit, **shih shtojcën 5.**

Kriteret për dhënien e një Kontrate

Kontratat duhet të jepen duke u bazuar në këto kritere:

- A. Në rast të furnizimit me mallra- e bazuar në çmimin më të ulët;
- B. Në rastin e ndërtimit (nënkupton rezultatin e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë civile që vetvetiu është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja dizajnimin dhe ekzekutimin) - bazuar në çmimin më të ulët;
- C. Në rast të shërbimeve (studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

Konflikti I Interesit

Konflikt interesi konsiderohet nëse përfituesi dhe ofertuesit/furnizuesit dhe ofrtuesit/furnizuesit dhe komisionit vlerësues janë:

- a) Të aferm, apo aksionare të përbashket;
- b) Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

Llojet e Blerjeve

- Blerje deri në 10,000.00 EUR,
- Blerje nga 10,000.01 EUR - 60,000.00 EUR;
- Blerje nga 60,000.01 EUR – 150,000.00 (shpallje publike nacionale);
- Blerje mbi 150,000.01 (shpallje ndërkombëtare)

Blerjet deri në vlerën prej 10,000.00 €

Rregullat:

- Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu,
- Kostoja e blerjes duhet t'i respektojë pragjet e vendosura në masë,
- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar në mes të shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës.
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

Blerjet nga 10,000.01 € deri më 60,000.00 €

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhet vetëm me së paku 3 oferta (kuotim i çmimit),
- Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata mes përfituesit dhe furnizuesit,
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat/detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit;
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për oferta, duke respektuar një format standard-shih **shtojcën nr. 1** të kontratës;
- Furnizuesit duhet të regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje/daljeve.
- Përfituesi duhet të nënshkruajë deklaratën për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit-shih **shtojcën nr. 2** të kontratës.
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë **deklaratën e tenderuesit të besueshëm-shih shtojcën 3**.
- Përfituesi vendos për dhënien e kontratës ofertuesit dhe argumenton arsyen e përzgjedhjes;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve

Blerjet mbi 60,000.00 €

Rregullat:

- Te gjitha dispozitat nga **NGA SLLAJDI PARAPRAK** duhet te respektohen;
- Perfituesi duhet ta publikoje interesin e tij per blerjen permes shpalljes ne se paku 1 gazete te perditshme kombetare, por ne qofte se vlera është me e larte se 150,000 €, tenderi duhet te paraqitet edhe ne mediet nderkombetare. Pervec kësaj, përfituesi ka te drejte te dergoj direkt ftesat per furnizuesit e mundshem per te siguruar nje konkurrence me te mire ne mesin e ofertave, por vetem ne te njejten dite kur eshte shpallur tenderi;
- Permbajtja e fteses publike duhet te perfshije te gjithë informacionin e paraqitur ne **Shtojcen 1**;
- Afati kohor per marrjen e ofertave duhet te jete te pakten 10 dite; Perfituesi do te krijoje nje komision vleresimi. Ky komision duhet te kete nje numer tek te anetareve, te pakten tre, me te gjitha kapacitetet teknike dhe administrative te nevojshme per te dhene nje opinion te vlefshem mbi tenderet;
- Komisioni i vleresimit duhet te leshoje nje vendim te argumentuar per dhenien e tenderit.
- Anetaret e komisionit te vleresimit duhet te nenshkruajne nje deklarate te konfidencialitetit dhe neutralitetit. **Shih Shtojcen 4**;
- Te gjitha kerkesat per pjesemarrje dhe tendere qe i plotesojne kerkesat, duhet te vleresohen dhe renditen nga komisioni i vleresimit ne baze te kriterëve te perzgjedhjes dhe dhenies se kontrates te shpallura paraprakisht;
- Perfituesi duhet te kerkoje dhe te pranoje kopjen e certifikates se regjistrimit te biznesit dhe kopjen e certifikates se numrit fiskal te ofertesve.

Kërkesa për Pagesë

- Të gjitha deklaratat e nënshkruara (sipas procedurës);
- Vendimi i komisionit apo përfituesit për perzgjedhjen e kompanisë;
- Kontrata e nënshkruar në mes dy palëve;
- Faturat origjinale,
- Transferi bankar per çdo blerje mbi 500 €;
- Kuponat fiskal per blerjet nën 500 €

Si të përgatiten faturat dhe transferet bankare

Për vlerat ma të mëdha se 500 euro

- Fatura duhet të jetë Original,
- Vlera e faturës për një blerje apo shërbim dhe vlera e transferit bankar në përputhje të plotë,
- Mund të paguhet me paradhënie për blerje apo shërbim vetëm nëse keni PROFATUR të të njejtës datë ose me datë të ma hershme,
- Vlera e nje blerje apo shërbimi mund të paguhet si paradhënie ne vlerë totale ose ne vlerë ma te vogël por me finalizimin e blerjes ose shërbimit vlera e fatures dhe vlera e transferit duhet të jenë ne përputhje te plotë,
- Nëse keni pagesa me paradhënie (totali apo pjesërisht) pas përfundimit të blerjes ose shërbimit duhet të keni FATURË të rregullt e cila është në përputhje të plote me vlerat e tranfereve.

Për vlerat ma të vogla se 500 euro

- Fatura dhe Kuponi Fiskal të jetë original,
- Të ketë përputhje të plotë të vlerës dhe dates së blerjes,
- Te perputhet emir personit fizik dhe i Kompanisë ne faturë dhe Kupon Fiskal,
- Ndarja e një blerje apo shërbimi të njejtë në shumë fatura dhe kupona fiskal për ti ikur transferit bankar do të merret si manipulim dhe shpenzimi nuk do të pranohet,

Kujdes: në rastet kur ka mos përputhshmeri të vlerave të faturës me transfer bankar dhe faturës me kuponin fiskal do të kalkulohet vlera ma e vogël e (Faturës apo e transferit).

Informata me rëndësi tek Faturat

- Kujdesu që emri i juaj (person fizik) apo emri i kompanis tuaj në faturë dhe në transferet bankare të jetë i saktë siç është në Kontratë,
- Të jenë të dhënat e furnitorit dhe blerësit të përfshira në faturë (NRB, NF, gjirrollogaria bankare dhe emri i saktë i bankës, numri I TVSH),
- Tegjitha blerjet dhe faturimi duhet të jenë para përfundimit të afatit të kontratës ose afatit shtesë te miratuar nga AZHB,

**RESPEKTIMI I RREGULLAVE PËR
KËRKESËN PËR PAGESË DHE
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ËSHTË
KUSHT
I DETYRUESHËM PËR TU PRANUAR
SHPENZIMET**

INFORMACIONET

- ÇDO DITË PUNE (HËNË-PREMTE)
 - **NGA ORA 10:00 – 12:00**
- AGJENCIONI PER ZHVILLIM BUJQËSISË
 - ZYRET RAJONALE